UDHËZIM
Nr. 2/1, datë 29.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA NR. 2, DATË 27.2.2013 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË MBROJTJES SOCIALE PËR VITIN 2013"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (i ndryshuar), ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", si dhe pikës 29/c të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2, datë 27.2.2013 "Për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të mbrojtjes sociale për vitin 2013", bëhen ndryshimet:

1. Pika 1/d riformulohet si më poshtë vijon:

d) "Financimin në zërin shpenzime korente të qendrave të përkujdesit social, të transferuara, me qëllim funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të tyre për sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore për qendrat e përkujdesit shoqëror, të transferuara".

2. Në pikën 13, shprehja "... transfertë e kushtëzuar në njësitë e qeverisjes vendore...", zëvendësohet me shprehjen "....shpenzime korente në qendrat e përkujdesit shoqëror të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore...".

3. Pika 13 e dyta, bëhet pika 14 dhe në këtë pikë ndryshohet shprehja "njësitë e qeverisjes vendore..." zëvendësohet me shprehjen "qendrat e përkujdesit shoqëror, të transferuara...".

4. Pika 14 bëhet pika 15 dhe në këtë pikë, pas shprehjes "njësitë e qeverisjes vendore" shtohet shprehja "dhe qendrat e përkujdesit shoqëror, të transferuara...".

5. Pika 15 hiqet.

6. Kudo në udhëzim që përdoret shprehja "qendrat e përkujdesit shoqëror", shtohet fjala "të transferuara".

7. Në pikën 16, baza ligjore "... ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012" zëvendësohet me "... ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013" dhe "Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2/1, datë 15.2.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012" zëvendësohet me "Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera